



| | | | |
|--|---------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijmjeño/Prodato Received/Delivery | 14. 11. 2022 | viti God Year | 2 |
| Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit | Nr Prot Bil. Prot Prot No | Shtojta Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/SHCK | 7085/2022 | | 1/6 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.802/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi - anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.802/2022 të 16.09.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë

kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës-zëvendësues*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.802/2022 e datës 16.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.ref:1355 i datës 25.08.2022 i Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

III. **OBLIGOHET** Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës "*Udhëheqës i Divizionit për të Huaj*", sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt emërimit me numër protokoli 332 të datës 07.05.2018.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt emërimit me numër protokoli 332 të datës 07.05.2018, në pozitën "*Udhëheqës i Divizionit për të Huaj*", në Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, me datë

25.08.2022 me Vendim me numër. ref:1355 të Sekretares të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është caktuar Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant", në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi i pakënaqur me caktimin e tij si Zëvendësues sipas Vendimit me numër ref:1355 të datës 25.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka parashtruar ankese me datë 16.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vendimi është nxjerre në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 30.09.2022 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Ministria e Punëve të Brendshme., ndërsa me datë 13.10.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, prej 1/31 faqe.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, sipas kërkesë së Kryetares së Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.10.2022 ka nxjerr Vendim VK.Nr.133/2022 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendimmarrje për ankesën e ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për marrjen e vendimit meritot administroj këto prova: Ankesën e datës 16.09.2022 me numër protokolli 5430/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 06.10.2021 drejtuar ankuesit; E-mail i datës 07.10.2021 nga ankuesi për znj.F.T.; Pasqyra e strukturës organizative organogrami i Ministrisë të Punëve të Brendshme; Vendimi me Nr.ref:1355 i datës 25.08.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Përgjigje e datë 13.10.2022 në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me numër protokolli 6136/2022; Ndryshim dhe plotësim të Akt emërimit nr. Protokolli 332 të datës 07.05.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.06.2015 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për të Huaj"; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, i datës 31.01.2022 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019, i datës 08.01.2020 për ankuesin; Vendim Nr.0490/2022 i datës 24.06.2022 me numër protokolli 0490 për themelimin e Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant, me seli në Vranidoll-Prishtinë; Vendimi Nr.1334/2022 i datës 22.08.2022 i nxjerrë nga Komisioni Disiplinor; E-mail i datës 25.08.2022 Njoftim nga z. T.T për znj. F.T.; E-mail i datë 25.08.2022 Njoftim nga z.L.L. për z.T.T.; E-mail i datës 24.06.2022 Vendimi për themelimin e Qendrës së Përkohshme e Pritjes për Migrant, nga z.A.K. për z.L.N.; Opinioni Ligjor i datës 07.06.2021 me numër protokolli 440 lëshuar nga Zv. Udhëheqësi i Divizionit për Koordinim të Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Vendimi VK.Nr.133/2022 i datës 25.10.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit me numër protokolli 332 të datës 07.05.2018, ka konstatuar se ankues!

është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për të Huaj", në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, ndërsa sipas Vendimit me Nr.ref:1355 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është caktuar Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant", në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër ref:1355 të datës 25.08.2022 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme për caktimin e tij si Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, pretendon se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e caktimit të tij si zëvendësues ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Organizimin e Brendshme dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe kundërshtim me dispozitat e nenit 24 dhe 32 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, po ashtu ankuesi pretendon se Zëvendësimi i tij është bërë pa njoftim paraprak të ankuesit veprim ky i cili bie ndesh me rregullat dhe parimet e përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik Ligjit dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj ankuesi në ankesën e tij propozon të anulohet Vendimi i datë 25.08.2022 i nxjerre nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ankuesi të kthehet në vendin e punës sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit me numër protokolli 332 të datës 07.05.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Vendimin me numër ref:1355 të datës 25.08.2022 për caktimin e ankuesit si „Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant“, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion nga pozita e "Udhëheqës i Divizionit për të Huaj", e ka nxjerre duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, ndërsa nuk ka aplikuar fare dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme Vendimin me numër. ref:1355 të datës 25.08.2022, për caktimin e ankuesit si „Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant“, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion nga pozita e "Udhëheqësit të Divizionit për të Huaj", e ka mbështetur në nenin 18 dhe nenin 20 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, të cilat nene nuk përbëjnë bazën ligjore për zëvendësimin e nëpunësve civil për pozitat e lira, sepse këto dispozita zbatohen për rastet kur pozitat e punës janë të plotësuara me nëpunës civil, mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroje detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore. Andaj, Kolegji konstaton se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme gabimisht e ka përdorur bazën ligjore të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, sepse rrjedhimisht ky Ligj i jep të drejtën e zëvendësimit të nëpunësve

civil, në raste të caktuara kur pozita është e plotësuar mirëpo kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroje detyrën për arsye të ndryshme, ndërsa nuk i jep asnjë të drejtë Sekretarit të Përgjithshëm që të zëvendësojë nëpunësit civilë për pozitat e lira sepse kjo procedurë rregullohet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të behet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla behet përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës, andaj Këshilli, duke marr parasysh se pozita e punës ka qenë e lire, konstaton se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e caktimit të ankuesit si zëvendësues, gjegjësisht zëvendësimi nuk është bërë për shkak këtyre rrethanave konform dispozitave ligjore të cekura si më lartë, dhe mbi këtë bazë është konstatuar se organi i punësimit gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e plotësimit të pozitës së lirë me zëvendësues duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, plotësimin e pozitës së lirë është dashur që ta bëjë përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar Vendimin me numër. ref:1355 të datës 25.08.2022, të nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se në arsyetimin e këtij vendimi është theksuar se, citoj: *... "meqenëse për momentin rekrutimi në Institucionet e administratës shtetërore për shkak pengesave ligjore deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publik, nuk është duke u zhvilluar dhe për këtë arsye i vetmi opsion për funksionalizimin e Qendrës është caktimi i stafit aktual, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme e ka propozuar z. duke u bazuar në përgatitjen profesionale të tij, por edhe në bazë të Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022, të Komisionit Disiplinor të punëve të Brendshme. Sipas këtij Vendimi dhe në bazë të arsyetimit të këtij vendimi z. nuk gëzon raporte kolegjale me zyrtarët nën varësi të tij, andaj, me qëllim të mbarë funksionimit të institucionit por edhe të njëjesisë përkatëse konkretisht të Divizionit për të Huaj, është vlerësuar si më adekuate që të caktohet Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se sa i përket këtij arsyetimi gjegjësisht referimit të Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022, dy nga tri shkeljet e supozuara nga ana e ankuesit për të cilat ka filluar procedura disiplinore konkretisht „Cenim i nëpunësve civil dhe përdorim i alkoolit në vendin e punës“ i ka refuzuar me arsyetimin që iniciuesi i procedurës disiplinore nuk ka dëshmuar me fakte dhe prova konkrete se ekzistojnë shkeljet e tilla të pretenduara në kërkesë për inicim të procedurës disiplinore po ashtu nuk janë dëshmuar as nga dëshmitarët që ankuesi ka bërë shkelje të tilla për çka është ngarkuar gjegjësisht Komisioni Disiplinor ka ardh në përfundim se nuk ka shkelje të rënda të detyrës zyrtare mbi bazën e së cilës ishte iniciuar procedura disiplinore,*

andaj Kolegji konstaton se ky është elementë mjaftë me rëndësi për të kuptuar se caktimi i ankuesit si „Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant“ nga pozita e "Udhëheqësit të Divizionit për të Huaj" mbi këtë arsytim se ankuesi „nuk gëzon raporte kolegjiale me zyrtarët nën varësi të tij, andaj, me qëllim të mbarë funksionimit të institucionit por edhe të njëjesisë përkatëse konkretisht të Divizionit për të Huaj, është vlerësuar si më adekuate që z. Haliti të caktohet Zëvendësues i Udhëheqësit të Qendrës së Përkohshme të Pritjes për Migrant“ nuk është i qëndrueshëm respektivisht arsytimi është i paqarte dhe kundërthënës në raport me faktet dhe provat, sepse vete Komisioni Disiplinor e ka refuzuar si të pabazuar këtë pretendim, ndërsa përdorja e të njëjtit fakt në cilësi të arsytimit, Vendimit me numër. ref:1355 të datës 25.08.2022, i jep më shumë formë të masës disiplinore sesa synimit të tij që ankuesi të caktohet në cilësi të zëvendësuesit.

Po ashtu sa i përket Vendimit me Nr. 1334/2022 të datës 22.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme me te cilin vendim ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 3 vjeçare", Kolegji konstaton se ky vendim është shfuqizuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr. 773/2022 të datës 03.11.2022, dhe si i tillë ky vendim nuk prodhon pasoja juridike, gjegjësisht të gjeturat e të njëjtit vendim tanimë i shfuqizuar për shkak të paligjshmërisë nuk mund të përdoren si arsytime në të ardhmen ndaj ankuesit me rastin e transferimit apo zëvendësimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Vendimi me numër ref:1355 i datës 25.08.2022, i nxjerrë nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është në kundërshtim edhe me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i atakuar me ankesën nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrative konkretisht nuk përmban saktë pjesën urdhëruese (dispozitivin), nuk përmban pjesën arsyetuese dhe nuk përmban këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsytimin) 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë...."; po ashtu arsytimi është në kundërshtim me nenin 48 të këtij ligji që përcaktohet se: "1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsytim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", sepse në rastin konkret arsytimi i vendimit është i paqartë dhe kundërthënës në vetvete dhe në raport me faktet dhe provat.

Andaj, bazuar si me lartë e duke u bazuar në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër ref:1355 i datës 25.08.2022, është akt administrativ i paligjshëm, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 55 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi për aprovimin e ankesës dhe rrjedhimisht shfuqizimin e aktit administrativ të kontestuar, duke detyruar njëkohësisht organin e punësimit që ankuesin ta kthej në pozitën e tij sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt emërimit me numër protokolli 332 të datës 07.05.2018, në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për të Huaj", në Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.802/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivitet të KPMSHCK- së.